



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-99693

Dt. 08.08.2025

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e _ së **Emo Kurtişi nga fsh.Lubinje e Poshtme**, Prizren me Pelqim me LRP.nr.7266/2025 nga noteri dhe me LRP.Nr. 17016/2023 Bilgaip Maznikar, në bazë të nenit 3 alineja 1 pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.7, 1.16, 1.17.1.5.1 dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alineja 1. Pika 1.1 nenin 15 alineja 1 pika 1.1 , e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 3 paragrafi 1 pika 1.6, 1.24 , 1.25 si dhe nenit 16 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 , konform nenit 34 e Rregullores për taksë Komunale nr.001/011-99275 dt.30.06.2022 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014,dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale Komunale(HZK)për periudhën 2022-2030-nr.001-011-48192 dt. 31.03.2022 e lidhur me nenin 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 27,44,46,47,48 si dhe nenit 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 merr këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Emo Kurtişi		
Adresa:	Rruga "Mahir Domi", nr.10		
Telefoni:	//	Emaili:	//

Emri i projektit	<u>mbindertim te etazhes (I dhe II) te objektit- shtepi banimi individual</u>		
Emri i projektuesit	"P.P."Melis",- Murat SezairiB.I.		
Adresa:	" Pllanjane" pn.		
Telefoni:		Emaili:	p.melis@gmail.com

Me këtë Vendim , aplikuesit për leje ndërtimore **Emo Kurtişi nga fsh.Lubinje e Poshtme**, në rrugën “ Mahir Domi“ nr. 10, Prizren i lejohet **mbindertim te etazhes (I dhe II) te objektit- shtëpi banimi individual nga P+0 egzistues ne P+2** në ngas.kad. **P-71813068-05466-24, O-71813068-2593-0** Z.K. Prizren

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	““ Mahir Domi““ nr. 10,	
Zonat (t) Kadastrale	<p>Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Prizren</p> <p>Objekti – <u>mbindertim te etazhes (I dhe II) te objektit- shtëpi banimi individual nga P+0 egzistues ne P+2</u> në ngas.kad. P-71813068-05466-24, O-71813068-2593-0 Z.K. Prizren me sipërfaqe parc. S=218m².</p> <p>Sipërfaqe bruto e perdheses egzistuese është S=81.15 m².</p> <p>Sipërfaqe bruto e katit I është S=74.0 m²</p> <p>Sipërfaqe bruto e kati II është S=63.0 m²</p> <p>Sipërfaqja bruto e mbindertimit te katit I dhe II eshte S=137.0m²</p> <p>Sipërfaqja neto e mbindertimit te katit I dhe II eshte S=112.21m²</p> <p>Sipërfaqja bruto e objektit S=137.0m² sipas lejes. Është miratuar taksa administrative për lëshimin e ndërtimore në shumën prej <u>768.26 €.</u></p> <p>- Paralogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej <u>60.896.70 €.</u></p>	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar: Mbindërtim <input checked="" type="checkbox"/> Rindertim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndertimeve te propozuera: Kategoria I <input type="checkbox"/> Kategoria II <input type="checkbox"/>
A perfshin kerkesa ndryshimin e destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Perdorimi i propozuar:objektit – <u>mbindertim te etazhes (I dhe II) te objektit- shtëpi banimi individual nga P+0 egzistues ne P+2</u> .

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Emo Kurtişi nga fsh.Lubinje e Poshtme**, në rrugën “ Mahir Domi“ nr. 10, Prizren i lejohet **mbindertim te etazhes (I dhe II) te objektit- shtëpi banimi individual nga P+0 egzistues ne P+2** në ngas.kad. **P-71813068-05466-24, O-71813068-2593-0** Z.K. Prizren

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Të dorëzoj njoftim inektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga proektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:

- Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Emo Kurtişi nga fsh.Lubinje e Poshtme,në rrugën “ Mahir Domi“ nr. 10, Prizren i lejohet mbindertim te etazhes (I dhe II) te objektit- shtepi banimi individual nga P+0 egzistues ne P+2 në ngas.kad. **P-71813068-05466-24, O-71813068-2593-0 Z.K. Prizren.**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Sipas njoftimit për plotësim të dokumentacionit.
- Raporti i qendrueshmerise-stabilitet (Statika).
- Kater kopje të projektit kryesor.

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Bashkëpunëtorë profesionale:

Zana Belloda inxh.dip.ark

DREJTORI

Pranverim Berisha jur.